



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ENERGJISË
DHE INDUSTRIË

URDHËR

Nr 201, Datë 20 / 6 / 2016

PËR MIRATIMIN E FORMËS SË INFORMACIONEVE TREMUJORE, VJETORE,
PËRFUNDIMTARE DHE PËRMBAJTJEN E PLANIT VJETOR TË PUNËS NGA ANA E
ZOTËRUESVE TË LEJEVE MINERARE TË SHFRYTËZIMIT ME KARRIERË PËR
GRUPIN E MINERALEVE NDËRTIMORE

Në zbatim të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 25, shkronjat "b", "ç" e "d", dhe nenit 56, pika 2 të ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010 "Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar;

URDHËROJ:

1. Formati i informacionit tremujor për veprimtarinë minerare të realizuar nga zotëruesi i lejes minerare të shfrytëzimit me karrierë për grupin e mineraleve ndërtimore, duhet të jetë në përputhje me formatin e përshkruar në aneksin 1 të këtij urdhëri. Ky informacion duhet të dërgohet on line (portali: raport.akbn.gov.al), pranë institucionit të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), jo më vonë se data 15 e muajit që vijon, për çdo tremujor kalendarik. Mosdërgimi në afat i këtij informacioni dënohet me masën administrative gjobë prej 100 000 (njëqind mijë) lekësh për çdo shkelje në përputhje me nenin 45, pika 1/ç të ligjit nr.10304, datë 15.7.2010 "Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.
2. Formati i informacionit vjetor për veprimtarinë minerare të realizuar nga zotëruesi i lejes minerare të shfrytëzimit me karrierë për grupin e mineraleve ndërtimore, duhet të jetë në përputhje me formatin e përshkruar në aneksin 2 të këtij urdhëri. Ky informacion duhet të dërgohet on line (portali: raport.akbn.gov.al), pranë institucionit të AKBN-së çdo vit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga përfundimi i vitit përkatës kalendarik. Mosdërgimi në afat i këtij informacioni dënohet me masën administrative gjobë prej 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekësh për çdo shkelje në përputhje me nenin 45, pika 1/d të ligjit nr.10304, datë 15.7.2010 "Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.
3. Formati dhe përmbajtja e planit vjetor të punës të parashikuar për t'u realizuar gjatë veprimtarisë minerare të vitit në vazhdim, të përcaktuar në përputhje me datën efektive të dhënies së lejes nga zotëruesi i lejes minerare të shfrytëzimit me karrierë për grupin e mineraleve ndërtimore, duhet të jetë në përputhje me planin e zhvillimit të veprimtarisë minerare të miratuar në lejen e tyre minerare dhe sipas formatit të përshkruar në aneksin 3 të këtij urdhëri. Ky plan duhet të dërgohet on line (portali: raport.akbn.gov.al), pranë institucionit të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike përpara përfundimit të vitit, llogaritur nga data e hyrjes në fuqi të lejes, për çdo vit. Mosdërgimi në afat i këtij informacioni dënohet me masën administrative gjobë 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë për çdo shkelje, në përputhje me nenin 45, pika 1/dh të ligjit nr.10304, datë 15.7.2010 "Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.


4. Subjektet minerare të cilat përmbajtjen e planit vjetor të punës nuk e kanë dorëzuar në përputhje me pikën 3 të këtij urdhëri, kanë të drejtë që brenda 10 ditësh nga marrja e njoftimit, të bëjnë përmirësimin e tij dhe ta dërgojnë atë on line (portali: raport.akbn.gov.al), pranë institucionit të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN).
5. Subjektet minerare të pajisura me leje minerare të shfrytëzimit me karrierë për grupin e mineraleve ndërtimore, duhet që në përfundim të afatit të lejes, apo përfundimit të saj përpara këtij afati, të përgatisin raportin përfundimtar për zhvillimin e veprimtarisë minerare, që duhet të jetë në përputhje me formatin e përshkruar në aneksin 4 të këtij urdhri, ku duhet të përshkruajnë në mënyrë të detajuar investimet e realizuara gjatë shfrytëzimit, punimet minerare të kryera në zonën e tij të lejuar, shoqëruar me vizatimet inxhinierike. Mosdërgimi i këtij informacioni dënohet me masën administrative gjobë 300 000 (treqind mijë) lekë në përputhje me nenin 45, pika 1/ë, të ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.
6. Subjektet minerare të pajisura me leje minerare të shfrytëzimit me karrierë për grupin e mineraleve ndërtimore, duhet të realizojnë planin e mbylljes së veprimtarisë minerare dhe planin e rehabilitimit përfundimtar të zonës së tyre, të lejuar dhe miratuar nga Ministri, në përputhje me kërkesat e ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.
7. Institucioni i AKBN-së, jo më vonë se 30 ditë pas përfundimit të çdo tremujori, duhet të dorëzojë në MEI raportin përmbledhës për veprimtarinë minerare të subjekteve, të pajisura me lejet minerare të shfrytëzimit me karrierë për grupin e mineraleve ndërtimore, që duhet të përmbajë të dhëna për:
 - a) realizimin e prodhimit;
 - b) realizimin e investimeve;
 - c) vlerën e produkteve të shitura;
 - d) vlerën e punimeve minerare të realizuara;
 - e) vlerën e operacioneve të kryera për rehabilitimin e mjedisit dhe menaxhimin e mbetjeve minerare.
8. Institucioni i AKBN-së, jo më vonë se 30 ditë pas përfundimit të çdo gjashtëmujori, duhet të dorëzojë në METE raportin përmbledhës për veprimtarinë minerare të subjekteve, të pajisura me lejet minerare të shfrytëzimit me karrierë për grupin e mineraleve ndërtimore, që duhet të përmbajë të dhëna për:
 - a) respektimin e realizimit të projektit minerar;
 - b) realizimin e operacioneve e të punimeve minerare dhe depozitimin e mbetjeve minerare;
 - c) lëvizjen e rezervave minerare;
 - d) kryerjen e operacioneve minerare në përputhje me normat e ruajtjes së mjedisit minerar,
 - e) duke u këshilluar me autoritetet e qeverisjes vendore të zonës minerare.
9. Institucioni i AKBN-së, jo më vonë se 60 ditë pas përfundimit të çdo viti, duhet të dorëzojë në MEI raportin përmbledhës për veprimtarinë minerare të subjekteve, të pajisura me lejet minerare të shfrytëzimit me karrierë për grupin e mineraleve ndërtimore, që duhet të përmbajë të dhëna për:
 - a) realizimin e prodhimit;
 - b) realizimin e investimeve;
 - c) vlerën e produkteve të shitura;
 - d) vlerën e punimeve minerare të realizuara;
 - e) vlerën e operacioneve të kryera për rehabilitimin e mjedisit dhe menaxhimin e mbetjeve minerare;
 - f) respektimin e realizimit të projektit minerar
 - g) vlerën e operacioneve e të punimeve minerare dhe depozitimin e mbetjeve minerare;
 - h) lëvizjen e rezervave minerare;
 - i) kryerjen e operacioneve minerare në përputhje me normat e ruajtjes së mjedisit minerar, duke u këshilluar me autoritetet e qeverisjes vendore të zonës minerare

10. Institucioni i AKBN-së propozon masat administrative në MEI, për çdo subjekt mineralar, për çdo rast të mosrespektimit të pikave 1, 2, 3 dhe 5 të këtij urdhëri.
11. Institucioni i AKBN-së vlerëson raportin përfundimtar të veprimtarisë minerare të shfrytëzimit me karrierë për grupin e mineraleve ndërtimore dhe realizimin e planit të mbylljes dhe planit të rehabilitimit të çdo subjekti mineralar dhe i paraqet për miratim ministrit vlerësimin e tij, në përputhje me kërkesat e ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010 "Për sektorin mineralar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.
12. Institucioni i AKBN-së vlerëson dhe miraton vlerat e garancive financiare vjetore për realizimin e planit të investimit dhe planit të rehabilitimit progresiv e përfundimtar të mjedisit jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga data e paraqitjes së tyre. Kalimi i këtij afati i konsideron këto vlera të miratuara.
13. Në rast pamundësie për të deklaruar raportimet online, subjektet minerare duhet t' i dorëzojnë ato brenda afateve ligjore, dorazi apo nëpërmjet shërbimit postar, në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore.
14. Agjencia Kombëtare të Burimeve Natyrore të njoftojë të gjitha subjekteve minerare dhe t' i trajtojë mbi mënyrën e plotësimit të formularëve dhe raportimeve on-line të informacioneve.
15. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet institucioni i AKBN-së dhe Drejtoria Përgjegjëse në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë.
16. Urdhëri, Nr 310, datë 13.04.2011, "Për miratimin e formës së informacioneve tremujore, vjetore, përfundimtare dhe përmbajtjen e planit vjetor të punës nga ana e zotëruesve të lejeve minerare të shfrytëzimit me karrierë për grupin e mineraleve ndërtimore", shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

DAMIAN GJIKNURI



ANEKSI 1
FORMATI I INFORMACIONIT TREMUJOR PËR VEPRIMTARINË MINERARE QË
DËRGOHET ON LINE NË AKBN NGA ZOTËRUESI I LEJES MINERARE TË
SHFRYTËZIMIT ME KARRIERË PËR GRUPIN E MINERALEVE NDËRTIMORE

- 1 Perjudha raportuese
 - a Tremujori i viti

- 2 Të dhëna mbi shoqërinë dhe lejen minerare
 - a Emri i subjektit sipas QKB
NIPTI
Data e miratimit në QKB
Objekti, emri
 - b Identifikimi i lejes minerare
Nr lejes
Data lejes
 - c Lloji i mineralit për të cilin është dhënë leja
Emërtimi i njësisë vendore ku kryhet aktiviteti
Tipi i shoqërisë, vendase, e huaj, ose join
venture

- 3 Të dhëna mbi zotëruesin e lejes minerare
 - a Emër, mbiemër të zotëruesit të lejes minerare
 - c Adresa e selisë së subjektit
 - d Emër mbiemër administratorit
 - e Numur telefoni
 - f Adresë e-mail
 - h Emër mbiemër drejtuesi teknik
 - i Nr i liçenses drejtuesit teknik

4. Formati i tabelës informuese tremujore:

Nr		Emërtimi	Njësia	Parashikimi	Realizimi	%
1	a	Prodhimi mineral në total (a1+a2+a3 +a4)	ton ose m ³			
	a1	Sasia e produktit të mineralit 1	ton ose m ³			
		Cilësia e produktit 1	%			
	a2	Sasia e produktit të mineralit 2	ton ose m ³			
		Cilësia produktit 2	%			
	a3	Sasia e produktit të mineralit 3	ton ose m ³			
		Cilësia produktit 3	%			
	a4	etj	ton ose m ³			
		etj	%			
	b	Nënproduktet e përpunuara	ton ose m ³			
	b1	Sasia	ton ose m ³			
		Cilësi	%			
	b2	Sasia	ton ose m ³			
		Cilësi	%			
	b3	Sasia	ton ose m ³			
		Cilësi	%			
	c	Punime minerare të realizuara (c1+c2+c3+c4)	ml			
	c1	Punime kërkimi	ml			
	c2	Punime kapitale	ml			
	c3	Transhe, gjysëm transhe	ml			
	c4	Rrugë	ml			
	c5	Sheshe depozitimi minerali dhe sterili	m ²			
	c6	Punime zbulimi	m ³			
	d	Punime gjeologjike të realizuara (d1+d2+d3+d4)	ml			
	d1	Rilevime të ndryshme	ml			
	d2	Kanale dhe pusëza, etj	ml			
	d3	shpime	ml			
	d4	etj	ml			
	e	Sasia e mbetjeve minerare të depozituara në sipërfaqe	m ³			
2		Realizimi i investimeve dhe punimeve gjeologjike minerare (a+b+c)	Lekë			
	a	Punime minerare (a1+a2+a3+a4)	Lekë			
	a1	Transhe, gjysëm transhe	Lekë			
	a2	Rrugë	Lekë			
	a3	Sheshe depozitimi minerali dhe sterili	Lekë			
	a4	Punime zbulimi	Lekë			
	b	Punime gjeologjike (b1+b2+b3+b4)	Lekë			
	b1	Rilevime të ndryshme	Lekë			
	b2	Kanale dhe pusëza, etj	Lekë			
	b3	shpime	Lekë			
	b4	etj	Lekë			
	c	Makineri e paisje	Lekë			
3	a	Vlera e produkteve minerare të shitura në total (a1+a2), në të njëjtën monedhë	Lekë ose USD			
	a1	Vlera e produkteve minerare të shitura në vend	Lekë			
		Çmimi mesatar i shitjes në vend	Lekë/ton ose lekë/ m ³			
	a2	Vlera e produkteve minerare të eksportuara	USD			
		Çmimi mesatar i eksportit	USD/ton ose USD/m ³			
4		Fuqia puntore në total	Nr			
5		Fuqia puntor me sigurim jete	Nr			
6		Pagesa e rentës minerare	Lekë			
7		Pagesa për sigurimin e jetës sëpuntorëve	Lekë			

Shënim: Shitjet të shoqërohen me fotokopjo të faturave përkatëse.

Zotëruesi i lejes minerare të shfrytëzimit

Emër, mbiemër, firmë

vula

Vendi dhe data

ANEKSI 2

FORMATI I INFORMACIONIT VJETOR PËR VEPRIMTARINË MINERARE QË DËRGOHET ON LINE NË AKBN NGA ZOTËRUESI I LEJES MINERARE TË SHFRYTËZIMIT ME KARRIERË PËR GRUPIN E MINERALEVE NDËRTIMORE

1. Raporti financiar e teknik duhet të dërgohet on line, (portali: raport.akbn.gov.al), pranë AKBN-së, çdo vit jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga përfundimi i vitit përkatës të llogaritur me datën efektive dhe duhet të përmbajë një raport informativ mbi realizimin e prodhimit, investimeve, vlerën e produkteve të shitura, punimeve minerare të realizuara, operacioneve të kryera për rehabilitimin e mjedisit dhe menaxhimin e mbetjeve minerare, në përputhje me detyrimet e tij të lejes minerare dhe planin vjetor të ndarë në kapitujt e mëposhtëm:

- a) Realizimi i prodhimit dhe punimeve minerare gjatë periudhës një vjecare;
- b) Realizimi i investimeve të dhëna për vlerën punimeve minerare të realizuara, vlerën e operacioneve të kryera për rehabilitimin e mjedisit dhe menaxhimin e mbetjeve minerare;
- c) Të dhëna për vlerën e produkteve të shitura, taksave të paguara;
- d) Raportin markshederik për lëvizjen e rezervave minerare;
- e) Vlerësimin krahasues për respektimin e realizimit të projektit mineral, realizimin e operacioneve e të punimeve minerare, depozitimin, trajtimin, menaxhimin e mbetjeve minerare dhe rehabilitimin mjedisor në përputhje me normat e ruajtjes së mjedisit mineral.

Në mënyrë më të detajuar për aspektet gjeologjike:

- a. Relacion i shkurtër gjeologjik mbi rezultatet e punimeve të kryera;
- ii) Volumet e punimeve sipërfaqësore të kryera, si: rilevim gjeologo - topografik, prerje të shkallëve nga 1:25000 deri në shkallën 1:1000, të shoqëruara me hartat dhe prerjet gjeologjike përkatëse;
- iii) Volumet e punimeve minerare të kryera, si: zbulim, transhe, shkallë, etj, të shoqëruar me dokumentime gjeologjike, foto, planimetri të punimeve të kryera, prerje kërkim-zbulimi dhe shfrytëzimi në shkallët 1:100 -1:1000;
- iv) Sasia e provave të marra për studime kërkim-zbulimi mineral, si dhe rezultatet e analizave të kryera në rajonin e licencuar;
- v) Informacion mbi punimet e kryera për rehabilitimin e mjedisit, si: mbyllje punimesh minerare dhe mbjellje pemësh etj.

Në mënyrë më të detajuar për aspektet minerare:

- i) Frontet ku është zhvilluar veprimtaria minerare dhe çdo veprimtari tjetër që lidhet me detyrimet e lejes minerare dhe programit vjetor;
- ii) Raportin markshederik për lëvizjen e rezervave të shoqëruar me planimetritë e punimeve të kryera, prerjet në shkallët 1:100 -1:1000;
- iii) Gjendjen e punimeve minerare të shoqëruar me skica, foto, planimetri, prerje në shkallë 1:100 -1:1000;
- iv) Veprimtaria minerare për menaxhimin e trajtimin e mbetjeve dhe rigjenerimin e mjedisit;
- v) Shpenzimet financiare në lekë mbi punimet e kryera, sipas zërave dhe në total, krahasimi i tyre me realizimin e programit të investimit, të përcaktuar në projektin e zhvillimit të veprimtarisë minerare;
- vi) Llogaritjet e realizimit të programit të investimit për të vlerësuar garancinë e realizimit të programit të investimit;
- vii) Informacion për respektimin e kërkesave të sigurisë në punë dhe mbrojtjes së shëndetit të punonjësve;
- viii) Informacion për plotësimin e kërkesave të nismës për transparencë në industrinë nxjerrëse;
- ix) Shpjegime dhe argument mbi mosrealizimet eventuale të programit vjetor për periudhën raportuese;
- x) Çdo shpjegim tjetër që zotëruesi i lejes minerare e gjykon të arsyeshme t'ia bëjë të

njohur strukturës përgjegjëse.

xi) Subjekti në mbrojtje të programit vjetor të zhvillimit të veprimtarisë minerare, duhet të paraqesë njo kopjo të Raporti financiar e teknik, të printuar.

2. Në përfundim të pjesës narrative, Raporti financiar e teknik duhet të përmbajë, gjithashtu, tabelat e përshkruara më poshtë.

Tabelat përmbledhëse të veprimtarisë minerare vjetore të subjektit minerar të pajisur me lejen minerare të shfrytëzimit me karrierë për grupin e mineraleve ndërtimore nr....., datë/...../.....

- 1 Periudha raportuese
- a Periudha vjetore / / / /

- 2 Të dhëna mbi zotëruesin e lejes minerare
- a Emri i subjektit sipas QKB
NIPTI
Data e miratimit në QKB
Objekti, emri
- b Identifikimi i lejes minerare
Nr lejes
Data e lejes
Lloji i mineralit për të cilin është dhënë leja
Emërtimi i njësisë vendore ku kryhet aktiviteti
Tipi i shoqërisë, vendase, e huaj, ose joint venture

- 3 Të dhëna mbi zotëruesin e lejes minerare
- c Emër, mbiemër të zotëruesit të lejes minerare
- e Adresa e selisë së subjektit
- f Emër mbiemër administratorit
- g Numur telefoni
- h Adresë e-mail
- j Emër mbiemër drejtuesi teknik
- k Nr i liçenses drejtuesit teknik

4. Formati i tabelës informuese vjetore

Nr	Emërtimi	Njësia	Parashikimi	Realizimi	%
1	a	Prodhimi mineralar në total (a1+a2+a3 etj)	ton ose m ³		
	a1	Sasia e produktit të mineralit 1	ton ose m ³		
		Cilësia e produktit 1	%		
	a2	Sasia e produktit të mineralit 2	ton ose m ³		
		Cilësia produktit 2	%		
	a3	Sasia e produktit të mineralit 3	ton ose m ³		
		Cilësia produktit 3	%		
	a4	etj	ton ose m ³		
		etj	%		
	b	Nënproduktet e përpunuara	ton ose m ³		
	b1	Sasia	ton ose m ³		
		Cilësi	%		
	b2	Sasia	ton ose m ³		
		Cilësi	%		
	b3	Sasia	ton ose m ³		
		Cilësi	%		
	c	Punime minerare të realizuara (c1+c2+c3+c4)	ml		
	c1	Punime kërkimi	ml		
	c2	Punime kapitale	ml		
	c3	Transhe, gjysëm transhe	ml		
	c4	Rrugë	ml		
	c5	Sheshe depozitimi minerali dhe sterili	m ²		
	c6	Punime zbulimi	m ³		
	d	Punime gjeologjike të realizuara (d1+d2+d3+d4)	ml		
	d1	Rilevime të ndryshme	ml		
	d2	Kanale dhe pusëza, etj	ml		
	d3	shpime	ml		
	d4	etj	ml		
	e	Sasia e mbetjeve minerare të depozituar në sipërfaqe	m ³		
2		Realizimi i investimeve dhe punimeve gjeologjike minerare (a+b+c)	Lekë		
	a	Punime minerare (a1+a2+a3+a4)	Lekë		
	a1	Transhe, gjysëm transhe	Lekë		
	a2	Rrugë	Lekë		
	a3	Sheshe depozitimi minerali dhe sterili	Lekë		
	a4	Punime zbulimi	Lekë		
	b	Punime gjeologjike (b1+b2+b3+b4)	Lekë		
	b1	Rilevime të ndryshme	Lekë		
	b2	Kanale dhe pusëza, etj	Lekë		
	b3	shpime	Lekë		
	b4	etj	Lekë		
	c	Makineri e paisje	Lekë		
3	a	Vlera e produkteve minerare të shitura në total (a1+a2), në të njëjtën monedhë	Lekë ose USD		
	a1	Vlera e produkteve minerare të shitura në vend	Lekë		
		Çmimi mesatar i shitjes në vend	Lekë/ton ose lekë/ m ³		
	a2	Vlera e produkteve minerare të eksportuara	USD		
		Çmimi mesatar i eksportit	USD/ton ose USD/m ³		
4		Rehabilitimi i mjedisit (a+b)	Lekë		
	a	Rehabilitimi i mjedisit të dëmtuar	Lekë		
	b	Menaxhimi i mbetjeve minerare	Lekë		
5		Pagesa e taskës lokale	Lekë		
6		Garancia e investimeve	Lekë		
7		Garancia e rehabilitimit	Lekë		
8		Fuqia puntore në total	Nr		
9		Fuqia puntor me sigurim jete	Nr		
10		Pagesa e rentës minerare	Lekë		

11		Pagesa për sigurimin e jetës sëpuntorëve	Lekë			
12		Pagesa e rentës minerare	Lekë			

Shënim: Shitjet të shoqërohen me fotokopjo të faturave përkatëse.

5. Tabela e gjëndjes dhe lëvizjes së rezervave

Nr	Lloji i rezervave	Gjëndja e rezervave në fillim të vitit raportues,		Konsumi i rezervave gjatë vitit				Gjëndja e rezervave në fund të vitit raportues ...	
		Sasia (ton ose m ³)	Cilësia %	Planifikuar		realizuar		Sasia (ton ose m ³)	Cilësia %
				Sasia (ton ose m ³)	Cilësia %	Sasia (ton ose m ³)	Cilësia %		
1	Të hapura (ton ose m ³)								
2	Të përgatitura (ton ose m ³)								
3	Të gatshme (ton ose m ³)								
4	Të shtuara								
	Total (1+2+3+4)								

Zotëruesi i lejes minerare të shfrytëzimit

Emër, mbiemër, firma

Vula

Vendi dhe data

ANEKSI 3

FORMATI I PLANIT VJETOR TË PUNËS PËR VEPRIMTARINË MINERARE QË DËRGOHET ON LINE NË AKBN NGA ZOTËRUESI I LEJES MINERARE TË SHFRYTËZIMIT ME KARRIERË PËR GRUPIN E MINERALEVE NDËRTIMORE

1. Plani vjetor i veprimtarisë minerare për vitin pasardhës, duhet të dërgohet on line, (portali: raport.akbn.gov.al) pranë AKBN-së çdo vit 30 (tridhjetë) ditë kalendarike përpara përfundimit të vitit përkatës, të llogaritur me datën efektive të lejes minerare dhe duhet të përmbajë në mënyrë të specifikuar dhe të detajuar në tremujorë, kapacitetet e prodhimit, vlerën e investimeve dhe operacionet që do të kryhen nga ana e subjektit gjatë veprimtarisë së tij minerare njëvjeçare.
2. Subjektet minerare në kapitull të veçantë duhet të paraqesin vlerësimin e tyre për vlerat e garancisë për realizimin e planit të investimit dhe garancisë për realizimin e planit të rehabilitimit, në përputhje dhe të harmonizuar në kohë, me të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në lejen minerare.
3. Institucioni i AKBN-së jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga data e paraqitjes së planit vjetor minerar miraton vlerat e garancisë për realizimin e planit të investimit dhe garancisë për realizimin e planit të rehabilitimit. Në rast mosmiratimi, AKBN-ja e njofton zotëruesin e lejes minerare për arsyet e mosmiratimit. Nëse kjo përgjigje nuk kthehet brënda këtij afati, plani dhe vlerat e garancive quhen të miratuara.
4. Subjekti në mbrojtje të Planit vjetor të veprimtarisë minerare, duhet të paraqesë një kopjo të tij, të printuar.
5. Plani vjetor i veprimtarisë minerare duhet të bashkëshoqërohet me dokumentet e mëposhtme teknike:
 - a. Hartën gjeologo-topografike të karrie rës shkalla 1:500 ose 1:1000;
 - b. Planimetrinë e përgjithshme të karrierës me punimet e hapjes, të azhurnuar deri në fund të periudhës raportuese, planimetritë e horizonteve, profilet kryesore, projeksioni vertikal ku me ngjyra të ndryshme të shënohen: punimet e planifikuara dhe ato të kryera në shkallën 1:200 ose 1:500;
 - c. Pasaportën e shfrytëzimit;
 - d. Pasaportat e punimeve kryesore;
 - e. Sheshet e depozitimit të mineralit dhe sterileve të zbulimit në shkallën 1:200 ose 1:500;
 - f. Masat e programuara për rehabilitimin progresiv dhe përfundimtar të mjedisit në shkallën 1:200 ose 1:500.
6. Plani vjetor i veprimtarisë minerare duhet të përmbajë tabelat Nr 1 dhe Nr 2 si më poshtë.
7. Miratimi i planit vjetor të veprimtarisë minerare do të dërgohet elektronikisht subjektit në adresën e e-mail të deklaruar

1. Formati i tabelës së planit vjetor minerar:

Nr		Emërtimi	Njësia	Parashikimi					
				T1	T2	T3	T	Viti	
1	a	Prodhimi minerar në total (a1+a2+a3 etj)	ton ose m ³						
	a1	Sasia e produktit të mineralit 1	ton ose m ³						
		Cilësia e produktit 1	%						
	a2	Sasia e produktit të mineralit 2	ton ose m ³						
		Cilësia produktit 2	%						
	a3	Sasia e produktit të mineralit 3	ton ose m ³						
		Cilësia produktit 3	%						
	a4	etj	ton ose m ³						
		etj	%						
	b	Nënproduktet e përpunuara	ton ose m ³						
	b1	Sasia	ton ose m ³						
		Cilësi	%						
	b2	Sasia	ton ose m ³						
		Cilësi	%						
	b3	Sasia	ton ose m ³						
		Cilësi	%						
	c	Punime minerare të realizuara (c1+c2+c3+c4)	ml						
	c1	Punime kërkimi	ml						
	c2	Punime kapitale	ml						
	c3	Transhe, gjysëm transhe	ml						
c4	Rrugë	ml							
c5	Sheshe depozitimi minerali dhe sterili	m ²							
c6	Punime zbulimi	m ³							
d	Punime gjeologjike të realizuara (d1+d2+d3+d4)	ml							
d1	Rilevime të ndryshme	ml							
d2	Kanale dhe pusëza, etj	ml							
d3	shpime	ml							
d4	etj	ml							
e	Sasia e mbetjeve minerare të depozituara në sipërfaqe	m ³							
2		Realizimi i investimeve dhe punimeve gjeologjike minerare (a+b+c)	Lekë						
	a	Punime minerare (a1+a2+a3+a4)	Lekë						
	a1	Transhe, gjysëm transhe	Lekë						
	a2	Rrugë	Lekë						
	a3	Sheshe depozitimi minerali dhe sterili	Lekë						
	a4	Punime zbulimi	Lekë						
	b	Punime gjeologjike (b1+b2+b3+b4)	Lekë						
	b1	Rilevime të ndryshme	Lekë						
	b2	Kanale dhe pusëza, etj	Lekë						
	b3	shpime	Lekë						
	b4	etj	Lekë						
	c	Makineri e paisje	Lekë						
	3	a	Vlera e produkteve minerare të shitura në total (a1+a2), në të njëjtën monedhë	Lekë ose USD					
		a1	Vlera e produkteve minerare të shitura në vend	Lekë					
		Çmimi mesatar i shitjes në vend	Lekë/ton ose lekë/ m ³						
a2		Vlera e produkteve minerare të eksportuara	USD						
	Çmimi mesatar i eksportit	USD/ton ose USD/m ³							
4		Rehabilitimi i mjedisit (a+b)	Lekë						
	a	Rehabilitimi i mjedisit të dëmtuar	Lekë						
	b	Menaxhimi i mbetjeve minerare	Lekë						
5		Pagesa e taskës lokale	Lekë						
6		Garancia e investimeve	Lekë						

7		Garancia e rehabilitimit	Lekë					
8		Fuqia puntore në total	Nr					
9		Fuqia puntor me sigurim jete	Nr					
10		Pagesa e rentës minerare	Lekë					
11		Pagesa për sigurimin e jetës sëpuntorëve	Lekë					
12		Pagesa e rentës mincrare	Lekë					

2. Tabela e gjëndjes dhe lëvizjes së rezervave

Nr	Lloi i rezervave	Gjëndja e rezervave në fillim të vitit raportues, ...		Konsumi i planifikuar i rezervave gjatë vitit			
				Planifikuar		realizuar	
		Sasia (ton ose m ³)	Cilësia %	Sasia (ton ose m ³)	Cilësia %	Sasia (ton ose m ³)	Cilësia %
1	Të hapura (ton ose m ³)					1	
2	Të përgatitura (ton ose m ³)					1	
3	Të gatshme (ton ose m ³)					1	
4	Të shtuara						
	Total 1+2+3 +4(ton ose m ³)						

Inxhinier i licensuar Marksheider ose Topograf ose
 Inxhinier i licensuar Gjeolog
 Inxhinier i licensuar Miniere
 Inxhinier i licensuar Pasurues
 Drejtues Teknik
 Zotëruesi i lejes minerare të shfrytëzimit
 Emër mbiemër
 Vula
 Vendi dhe data

Emër, mbiemër nr. licencës.
 Emër, mbiemër nr. licencës.
 Emër, mbiemër nr. licencës.
 Emër, mbiemër nr. licencës.
 Emër, mbiemër nr. licencës.

firma
 firma
 firma
 firma
 firma

ANEKSI 4
FORMATI I RAPORTIT PËRFUNDIMTAR PËR VEPRIMTARINË MINERARE QË
DËRGOHET ON LINE NË AKBN NGA ZOTËRUESI I LEJES MINERARE TË SHFRYTËZIMIT
ME KARRIERË PËR GRUPIN E MINERALEVE NDËRTIMORE

1. Raporti Përfundimtar duhet të dërgohet on line, (portali: raport.akbn.gov.al), pranë AKBN-së, për vlerësim, në përfundim të afatit të lejes minerare dhe duhet të përmbajë një raport të detajuar informativ mbi realizimin e prodhimit, investimeve, vlerën e produkteve të shitura, punimeve minerare të realizuara, shfrytëzimin e rezervave dhe gjendjen e rezervave të mbetura, operacioneve të kryera për rehabilitimin e mjedisit dhe menaxhimin e mbetjeve minerare, dhe situatën përfundimtare mjedisore pas realizimit të rehabilitimit në përputhje me detyrimet e tij të lejes minerare dhe planin e veprimtarisë minerare të ndarë në kapitujt e mëposhtëm:
 - a. Realizimi i prodhimit dhe punimeve minerare, vjetore dhe gjatë periudhës së lejes minerare;
 - b. Realizimi i investimeve vjetore dhe në total, të dhëna për vlerën punimeve minerare të realizuara, vlerën e operacioneve të kryera për rehabilitimin e mjedisit dhe menaxhimin e mbetjeve minerare;
 - c. Të dhëna për vlerën e produkteve të shitura, taksave të paguara;
 - d. Raportin markshederik për lëvizjen e rezervave minerare dhe gjendjen përfundimtare të tyre;
 - e. Vlerësimin krahasues për respektimin e realizimit të projektit minerar, realizimin e operacioneve e të punimeve minerare, depozitimin, trajtimin, menaxhimin e mbetjeve minerare dhe rehabilitimin mjedisor në përputhje me normat e ruajtjes së mjedisit minerar.
 - f. Raportin vlerësues për rehabilitimin përfundimtar të mjedisit dhe depozitimit të mbetjeve minerare së bashku me masat që propozohen për monitorimin postminerar;

Në mënyrë më të detajuar për aspektet gjeologjike:

- i) Relacion i plotë gjeologjik që përmban rievim gjeologo-topografik, prerje të shkallëve në shkallën 1:1000, të shoqëruara me hartat dhe prerjet gjeologjike përkatëse;
 - ii) Në mënyrë më të detajuar për aspektet gjeologjike:
 - iii) Relacion i plotë gjeologjik që përmban rievim gjeologjik, gjeofizik, gjeokimik, marshute - prerje të shkallëve në shkallën 1:1000, të shoqëruara me hartat dhe prerjet gjeologjike përkatëse.
 - iv) Në mënyrë më të detajuar për aspektet minerare:
 - v) Frontet ku është zhvilluar veprimtaria minerare dhe çdo veprimtari tjetër që lidhet me detyrimet e lejes minerare dhe programit vjetor;
 - vi) Raportin markshederik për lëvizjen e rezervave të shoqëruar me planimetritë e punimeve të kryera, prerjet në shkallët 1:100 -1:1000: dhe gjendjen përfundimtare të rezervave;
 - vii) Gjendjen e punimeve minerare të shoqëruar me skica, foto, planimetri, prerje në shkallë 1:100 -1:1000 dhe propozimet përkatëse për monitorimin post minerar;
 - viii) Përshkrim të aktiviteteve për menaxhimin e trajtimin e mbetjeve dhe rigjenerimin e mjedisit;
 - ix) Vlerën vjetore dhe totale të investimit të realizuar;
 - x) Vlerën vjetore dhe totale të prodhimit të realizuar
2. Në përfundim të pjesës narrative, Raporti financiar e teknik duhet të përmbajë, gjithashtu, tabelat e përshkruara më poshtë.

Tabelat përfundimtare të veprimtarisë minerare të subjektit minerar të pajisur me lejen minerare të shfrytëzimit me karrierë për grupin e mineraleve ndërtimore nr....., datë/...../.....

- 1 Të dhëna mbi zotëruesin e lejes minerare
- a Emri i subjektit sipas QKB
NIPTI
Data e miratimit në QKB
Objekti, emri
- b Identifikimi i lejes minerare
Nr lejes
Data e lejes
Lloji i mineralit për të cilin është dhënë leja
Emërtimi i njësisë vendore ku kryhet aktiviteti
Tipi i shoqërisë, vendase, e huaj, ose join venture
- 2 Të dhëna mbi zotëruesin e lejes minerare
- c Emër, mbiemër të zotëruesit të lejes minerare
- e Adresa e selisë së subjektit
- f Emër mbiemër administratorit
- g Numur telefoni
- h Adresë e-mail
- j Emër mbiemër drejtuesi teknik
- k Nr i licenses drejtuesit teknik

3. Formati i tabelës përfundimtare

Nr		Emërtimi	Njësia	Vitet						% në raport me parashikimin e planit të veprimtarisë minerare
				1	2	3			Totali	
1.	a	Prodhimi mineral në total (a1+a2)	ton ose m ³							
	a1	Sasia e produktit të 1	ton ose m ³							
		Cilësia e produktit të 1	%							
	a2	Sasia e produktit të 2	ton ose m ³							
		Cilësia produktit 2	%							
	b	Prodhimet e përpunuara	ton ose m ³							
	b1	Sasia	ton ose m ³							
	b2	Cilësi	%							
	c	Punime minerare (c1+c2+c3+c4)	ml							
	c1	Punime kërkimi	ml							
	c2	Punime kapitale	ml							
	c3	Transhe, gjysëm transhe	ml							
	c4	Rrugë	ml							
	d	Punime gjeologjike (d1+d2)	ml							
	d1	Rilevime të ndryshme	ml							
	d2	Kanale dhe pusëza, etj	ml							
	e	Sasia e mbetjeve minerare të depozituara në sipërfaqe	m ³							
2.		Realizimi i investimeve në total	Lekë ose USD							
3.		Makineri e pajisje , ndërtim montime	Lekë ose USD							
		Vlera e produkteve të shitura në total	Lekë ose USD							
		Vlera e produkteve të shitura në eksport	Lekë ose USD							
4		Rehabilitimi i mjedisit (a+b)	Lekë ose USD							
	a	Rehabilitimi i mjedisit të dëmtuar	Lekë ose USD							
	b	Menaxhimi i mbetjeve minerare	Lekë ose USD							
5		Fuqia puntore	Lekë ose USD							
6		Pagesa e taksës lokale në total	Lekë ose USD							
7		Pagesa e rentës minerare në total	Lekë ose USD							
8		Pagesa për sigurimin e jetës sëpuntorëve	Lekë ose USD							
9		Pagesa e garancisë së planit të rehabilitimit, total	Lekë ose USD							
10		Pagesa e garancisë së investimeve	Lekë ose USD							

3. Tabela e gjendjes dhe lëvizjes së rezervave

Nr	Lloji i rezervave	Gjëndja e rezervave në fillim të veprimtarisë minerare,		Konsumi i rezervave gjatë periudhës së lejes minerare // deri //				Gjëndja e rezervave në fund të periudhës së lejes minerare // / ...	
				Planifikuar		Realizuar			
		Sasia (ton ose m ³)	Cilësia %	Sasia (ton ose m ³)	Cilësia %	Sasia (ton ose m ³)	Cilësia %	Sasia (ton ose m ³)	Cilësia %
1	Të hapura (ton ose m ³)								
2	Të përgatitura (ton ose m ³)								
3	Të gatshme (ton ose m ³)								
4	Të shtuara								
	Total (1+2+3+4)								

Inxhinier i licensuar Marksheider ose Topograf ose

Inxhinier i licensuar Gjeolog

Inxhinier i licensuar Miniere

Inxhinier i licensuar Pasurues

Drejtues Teknik

Zotëruesi i lejes minerare të shfrytëzimit

Emër mbiemër

Vula

Vendi dhe data

Emër, mbiemër nr. licencës.

Emër, mbiemër nr. licencës.

Emër, mbiemër nr. licencës.

Emër, mbiemër nr. licencës.

Emër, mbiemër nr. licencës.

firma

firma

firma

firma

firma